



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

RREGULLORE

“PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË BASHKINË VAU-DEJËS”

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë Vau-Dejës është bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në nenin 30 e vijues të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSF”, në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrotjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe në akte të tjera nënligjore në mbështetje të këtyre ligjeve.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është sigurimi i një veprimtarie administrative dhe vendimarrje të paanshme dhe transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtaret e zgjedhur apo të emëruar të Bashkisë Vau-Dejës, si edhe ushtrimi i funksioneve dhe detyrave të punonjësve të këtij institucioni jo në kushtet e konfliktit të interesave.

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësi dhe kompetencave për zbatimin e detyrimeve ligjore për deklarimet e pasurive si dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave në institucion.

Neni 4

Përkufizime

1. *"Konflikt i interesit"* është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Konflikti i interesit përfshin edhe disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) *"Konflikt faktik i interesit"* është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij zyrtare.

b) *"Konflikt në dukje i interesit"* është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në form, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.

c) *"Konflikt i mundshëm i interesit"* është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

ç) *"Konflikt rast për rast i interesit"* është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimarrje të veçantë.

d) *"Konflikt i vazhdueshëm i interesit"* është gjendja në të cilën konflikti i interesit, mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

2. *"Zyrtar"* është çdo person që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në Bashkinë Vau Dejës.

3. *"Epror i një zyrtari"* është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni, që ka kompetenca, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

4. *"Eprori i përgjithshëm në institucion"* është Kryetari i Bashkisë Vau-Dejës.

5. "Person i lidhur me një zyrtar" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore me zyrtarin, sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 në lidhje me nenin 5 të po këtij ligji.

6. "Autoritet përgjegjes" është njësia e posacme përgjegjes e ngritur nga titullari i institucionit, sic është parashikuar në nenin 41 pika 2/b dhe nenin 42 pika 3, e ligjit nr.9396, e cila ka për detyrë parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve në konflikti interesi në institucion.

7. "Parim i proporcionalitetit" sipas pikës 12 të nenit 3, nenit 46 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar, është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësisë dhe kompetencave të një zyrtari të bashkisë me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

Neni 5

Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

1. çdo zyrtar i Bashkisë Vau-Dejës, i zgjedhur apo i emëruar, që ndodhen në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron funksione, të përcaktuara shprehimisht në ligjin Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjin Nr.9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
2. çdo zyrtar i Bashkisë Vau-Dejës i zgjedhur apo i emëruar, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për akte dhe kontrata administrative;
3. çdo zyrtar i Bashkisë Vau-Dejës i zgjedhur apo i emëruar, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte.
4. personat e zgjedhur apo të emëruar të lidhur në masen dhe mënyren e përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.05.2005, i ndryshuar, dhe nenin 30 e vijues të Kodit të Proçedurave Administrative në RSH, si dhe në nenin 49 dhe 52 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Neni 6

Vendimarrja dhe çastet paraprake të vendimarrjes

Për qëllimet të kësaj rregulloreje:

a. vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;

b. vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:

- i. hartimi i projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimi i tij organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;
- ii. dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, për këtë projekt- akt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
- iii. dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projekt-akt;
- iv. dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
- v. përfshirje e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, e të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative, pa praninë e të cilave nuk do të vendosej dhe mbështetej përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projekt-kontratës në tërësinë e tyre;
- vi. çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së bashkisë.

Neni 7

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Zyrtari i Bashkisë Vau-Dejës, i zgjedhur apo i emëruar, ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrje për këtë akt, sipas nenit 6 të rregullores, përcakton përmbajtjen e aktit.

2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

- a. roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
- b. zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për subjektet dhe ose ish-subjektet e bashkisë, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikat ekonomike dhe administrimin financiar në institucion.
- c. çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarit të bashkisë.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i bashkisë, i emëruar si i tillë nga Titullari i Institucionit.

5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7 , pikës 2 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.

- a) deklarimi rast për rast i interesave privatë bëhet çdo herë nga zyrtari i Bashkisë Vau Dejës, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi mund të kërkohej dhe të bëhej sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 8

Interesat privatë

Interesat private të zyrtarit publik të Bashkisë Vau-Dejës nuk duhet të ndikojnë në performancën e zyrtarëve të tij, duhet të jenë të paanshëm dhe objektiv tek detyrat e tyre.

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, e konkretisht:

- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
- b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- d) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- e) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse , sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- f) marrëdhënie:
 - i. familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii. të komunitetit;
 - iii. etnike;
 - iv. fetare;
 - v. të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- g) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktura në ligjin 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRAJTIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave.

Neni 9

Deklarimi rast për rasti i interesave private të zyrtarit

1. Çdo zyrtar i bashkisë, sipas përcaktimit të këtij termi në nenin 5 të kësaj rregulloreje, në organizimin e punës, kur përfshihet në një proces administrativ, vendimarrje apo kontrata të ndryshme administrative me të tretët, që mbikëqyrin apo përdorin fonde të ndryshme publike, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast pas rasti, të ekzistencës së interesave të tij private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet nga zyrtari, kur ai përfshihet në një proces administrativ, vendimarrje, apo kontrata të ndryshme administrative. Si rregull kjo deklaratë duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimarrje për një akt.

Neni 10

Identifikimi i interesave private të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit të bashkisë është:

- a) detyrë e çdo zyrtari të institucionit që ka dijeni;
- b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari të bashkisë, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

Neni 11

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari

1. Njësia e Burimeve Njërezore në bashki rast pas rasti duhet të vërë në dispozicion të zyrtarëve të emëruar modelin e autorizimit, që këta të fundit duhet të lëshojnë, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.

2. Autorizimi dorëzohet në Autoritetin Përgjegjës të Bashkisë Vau-Dejës për Parandalimin e Konfliktit të Interesave, si dhe në Njësinë e Burimeve Njërezore.

Neni 12

Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

2. Autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në bashki janë:

- a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda institucionit;
- b) drejtoritë dhe njësia e burimeve njërezore;

- të gjithë drejtorët e Drejtorive përkatëse pranë Bashkisë Vau-Dejës dhe përgjegjësit e sektorëve në mënyrë aktive të mbikqyrin stafin e tyre si:
 - t'ju kërkohet një kuptim i gjerë i deklaratave së pronave, interesave të secilit anëtar të stafit dhe interesat private të zbuluara nga ky moment si dhe detyrimet që ata kanë;
 - në baza të rregullta të kontrollohen vendimet nga anëtarët e stafit për çdo transaksion që ka dyshime për përfshirjen e interesave private;
 - secila Drejtori të ketë dosjen e punës me të dhënat;
 - c) komisioni i etikës i ngritur pranë Bashkisë Vau-Dejës ku ky komision ka rolet vijuese si më poshtë për zbulimin e konfliktit të fshehur të interesave:
 - Kontrollin e deklaratave vjetore për komplimentimin e të dhënave, në raste të të dhënave të pakompletuara, informojnë punëdhënësin për të filluar një revizion të hollësishëm të konfliktit të interesave;
 - Mos shpalosja e konfliktit të interesave=interesa private lidhur me:
 - Familjen, persona të tjerë të afërt, biznese etj që janë në konflikt interesi.
 - d) njësia e autoritetit përgjegjës në institucion e ngritur sipas udhëzimit nr.1, datë 27.6.2014 të ILDKP.
3. Autoritetet përgjegjës në bashki kanë për detyrë të zbatojnë detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9367, dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Funksioni dhe detyrat e autoritetit përgjegjës

Njësia e Autoritetit Përgjegjës në bashki e ngritur sipas Udhëzimit Nr. 1, datë. 27.6.2014 të ILDKPI-së është e përbërë prej 3 (tre) anëtarëve.

1. Drejtuesi i Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
2. Drejtuesi i Sektorit ligjor dhe Asistencës Juridike
3. Drejtuesi i Drejtorisë së Informimit, Publik, Medias, Statistikës dhe IT

1. Funksionimi dhe detyrat e Autoritetit Përgjegjës në drejtim të rolit parandalues.

- a) Mbledh nga burime të ligjshme të dhëna për interesat private të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar,
 - i. shpërndan dhe administron autorizimet e lëshuar nga zyrtarët e bashkisë pas emërimit në detyrë, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr 9367, datë 07/04/2005, i ndryshuar dhe nenit 11 të kësaj rregulloreje. Autorizimi sipas formatit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm në ILDKPKI, është i detyrueshem për tu plotësuar nga çdo zyrtar i cili kryen një funksion publik dhe nënshkruhet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës.
 - ii. Mbledh të dhëna personale për zyrtarin, në emër të institucionit, kudo që ato janë regjistruar në regjistrat publikë.

- b) Propozon nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, si edhe ndryshimet në rregulloret e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave të institucionit.
- c) Verifikon dhe kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave dhe vlerëson rastet konkrete të konflikteve të interesit.
- d) Plotëson dhe administron regjistrin e konflikteve rast pas rasti dhe mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- e) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit të tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave
- f) merr masa për të siguruar aksesin e informimit të publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit
- g) në bashkëpunim me sektorin e shërbimeve:
 - i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi
 - ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të BV, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Titullari i Institucionit;
 - iii. Siguron transparencën me publikun lidhur me vendimmarrjet e kryera nga bashkia dhe zbatimin me korrektësi të ligjit nr.8503, datë 30.06.1999 “ *Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare* ”
- h) Autoriteti Përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike"* , i ndryshuar, duhet të përgatisë listën e zyrtarëve të cilët në varësi të funksionit që kryejnë mbartin detyrimin për deklarim të interesave private, dhe të dërgojë kopje të saj në ILDKPKI.
- i) Informon zyrtarin lidhur me afatet ligjore brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklarata e interesave private, si edhe me sanksionet në rastet e refuzimit ose mosplotësimit brenda afatit ligjor.
- j) Propozon nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, si dhe ndryshimet në rregulloren e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në institucion.
- k) Në emër të institucionit, kryen verifikim dhe bën hetim administrativ lidhur me interesat private, që mund të bëhet shkak për lindje të një konflikti interesi.
- l) Autoriteti Përgjegjës pranon informacione të ofruar nga zyrtarë të tjerë apo persona të interesuar, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe verifikon/kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave.
- m) Në bazë të informacionit të grumbulluar, Autoriteti Përgjegjës bazuar në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, vlerëson nëse rasti konkret përbën konflikt interesi, duke analizuar njëkohësisht edhe rolin dhe kompetencat e zyrtarit në procesin vendimarrës.
- n) Verifikon dhe vlerëson nëse nga situata e konstatuar në kushte të konfliktit të

interesit kanë ardhur pasoja.

- o) I komunikon vetë zyrtarit dhe eprorit, të dhënat e mbledhura dhe shkeljet e konstatuara, duke i orientuar gjithashtu për masat që duhet të marrë vetë zyrtari apo eprori për zgjidhjen e konfliktit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 37 dhe 38 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.
- p) Përgadit jo më vonë se 31 Janar i vitit pasardhës një raport dhe ja paraqet ILDKPKI, mbi veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet me deklarinimin periodik.

Neni 14

Roli këshillues dhe trajnues i Autoritetit Përgjegjës

Autoriteti Përgjegjës i sugjeron zyrtareve dhe/ose eprorëve të tyre, çështje dhe momentet kur zyrtari, dhe/ose eprorët e tyre duhet për parandalimin e konfliktit të interesit rast për rast ose të vazhdueshëm.

Përgadit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave.

Merr masa për të siguruar aksesin dhe informimin e publikut në të dhënat personale të zyrtarve dhe në dokumentet e tjera të zyrtare që lidhen me konfliktin e interesave.

Neni 15

Detyrat e Autoritetit Përgjegjës në procesin e deklarinimit

- a) Autoriteti Përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”*, i ndryshuar, duhet të përgadisë listen e përditësuar të zyrtarëve të cilët në varësi të funksionit që kryejnë mbartin detyrimin për deklarinim të interesave private, dhe të dërgojnë kopjen e saj në ILDKPKI.
- b) Në rastet e emërimeve dhe largimeve të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarinim, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim ILDKPKI, lidhur me datën e emërimit/largimit të subjekteve.
- c) Orienton dhe udhëzon zyrtarët të cilët mbartin detyrim për deklarinimin për plotësimin në rrugë elektronike (me kompjuter) të deklarates së interesave private sipas llojeve *(para fillimit të detyrës, periodik vjetor, Pas largimit nga funksioni)*.
- d) Informon zyrtarët lidhur me afatet ligjore brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklarata e interesave private.
- e) Informon zyrtarët lidhur me sanksionet në rast refuzimi për plotësim të deklaratës, në rast mplotësimi brenda afatit si dhe në rastin e deklarinimit të rremë.
- f) Jep asistencë nëse kërkohet nga ana e zyrtareve në plotësimin e deklaratës.
- g) Mban databaze për shpërndarjen dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private të

zyrtarëve dhe pasi verifikon se dokumenti zyrtar është pa mangësi, lëshon për subjektin vërtetimin e marrjes në dorëzim.

- h) Mbledh deklaratat e plotësuar nga zyrtaret (subjekte të ligjit nr.9049, date 10.4.2003, i ndryshuar), dhe i dërgon pranë ILDKPI, sipas listet emërore të dorëzimeve.
- i) Përgadit raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit Përgjegjës të çdo viti pararendës, por jo më vonë se 31 janari i cili duhet të përmbajë:
 - i) procesin e deklarimit private periodike
 - ii identifikimin dhe rregjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 16

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të bashkisë, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga Autoriteti Përgjegjës i Institucionit dhe respekton formën tip të miratuar nga ILDKPKI.

Neni 17

Përgjegjësitë e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave

1. Autoritetit Përgjegjës, duhet të respektojë gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë se tij (edhe pas largimit të zyrtarit nga funksioni), parimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë në përputhje me përcaktimet e b
2. ra në ligjin nr.9887, datë 10.3.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*.
2. Në rastet kur konstatohet shkelje të detyrimeve ligjore nga kjo strukturë, Inspektoriati i Përgjithshëm i ILDKPKI, i propozon titullarit të institucionit masë disiplinore, në zbatim të pikës 3 të nenit 45, të ligjit nr.9367, si dhe ndërmerr procedurat për vendosjen e masave administrative “gjobë”, në zbatim të nenit 44 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

Neni 45-Masat disiplinore:

- Inspektori i Përgjithshëm, për shkeljen e kryer nga anëtarët e strukturës përgjegjëse të institucionit, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, i propozon titullarit të këtij institucioni largimin nga funksioni të këtij anëtar.

Neni 44-Kundërvajtjet administrative:

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:
 - a) për mosvetëdeklarim apo për mosdeklarim me kërkesë, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 7 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
 - b) për moslëshim autorizimi, sipas pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) për shkelje të nenit 21 pikat 1, 2, 3 e 6, nenit 22, nenit 23 pika 1 dhe nenit 24 pika 3 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të, personi i besuar ose drejtuesi i shoqërisë dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

ç) për shkelje të pikave 1 dhe shkronjave “a”, “c” dhe “e” të pikës 4 të nenit 37 dhe pikave 1, 2, 3, 5 e 8 të nenit 38 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;

d) kur paraqitet gjendja e përcaktuar në shkronjat “a” e “b” të pikës 2 të nenit 40/1, zyrtari dënohet me gjobë nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë; dh) kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë sipas pikës 1/1 të nenit 42 të këtij ligji personat përgjegjës të institucioneve publike dhe private gjobiten me 50 000 (pesëdhjetë mijë) leke deri 100 000 (njëqind mijë) leke.

dh) në rastet e shkeljeve të mësipërme, gjoba jepet nga Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e eprorit ose të institucionit epror ose, kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt, nga Inspektorati i Lartë;

e) për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër nga Inspektori i Përgjithshëm, e me propozimin e eprorit të strukturës së institucionit, në kuptim të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, të institucionit epror, ose kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Lartë, dënon personat përgjegjës me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqindmijë) lekë;

ë) për çdo masë administrative, Inspektori i Përgjithshëm njofton eprorin ose institucionin epror të zyrtarit të dënuar.

2. Gjobat janë më të larta, sipas vlerësimit të masës së shkeljes dhe sipas nivelit të rritjes së pozitës së zyrtarit.

3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre, rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative.

4. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi dhe derdhen në buxhetin e Inspektoratit të Lartë jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjobës. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune, ose nga zyra e përmbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm.

5. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë, bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes.

6. Kryerja e detyrave dhe ushtrimi i kompetencave nga ana e autoritetit përgjegjës në funksion të parandalimit të konfliktit të interesave, duhet të bëhet në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrotjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe aktet nënlogjore të dala në zbatim të tij.

Neni 18

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Autoriteti Përgjegjës i Institucionit, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të saj, interesat private të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyren e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat.

Seksioni 2

Identifikimi, regjistrimi, kufizimi i interesave private dhe trajtimi i rasteve me konflikt interesi

Neni 19

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të bashkisë, bëhet sipas kërkesave të kreut I të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e bashkisë, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarime periodike të interesave private sipas nenit 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar është Kryetari i Bashkisë:
3. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të bashkisë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.
4. Në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në bashki, brenda 15 ditëve nga momenti i largimit, Kryetari i lind detyrimi për të plotësuar dokumentin zyrtar ***"Deklaratë pas largimit nga funksioni"***. Autoriteti Përgjegjës është njësi përgjegjëse për plotësimin e kësaj pike me kusht që zyrtari në fjalë të ketë mundësinë për të tërhequr dokumentat e mëposhtme, si :
librezen e punës, librezen e kontributeve shoqërore, apo çdo dokument tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t'i takojnë zyrtarit pas largimit.

Neni 20

Llojet e interesave private që deklarohen periodikisht

Interesat private, që deklarohen periodikisht, janë ato të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10. 04.2003 , konkretisht:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publike;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 5 000 dollarë amerikanë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
- dh) detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizike, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.

Neni 21

Kufizimi i interesave private për parandalimin e konfliktit të interesave rast për rast për funksionaret e zgjedhur dhe të emëruar.

1. Kryetari i Bashkisë

- a) Nuk mund të jetë drejtues i organizatave fitimprurëse
 - b) Nuk mund të jetë anëtar në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose të një organizate jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të Bashkisë Vau Dejës.
 - c) Nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizik tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administrator i falimentit, ekspertit të licencuar, si dhe konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjen “b” të nenit 29 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.
 - d) Nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare që ushtron veprimtari brenda territorit të juridiksionit të Bashkisë Vau Dejës.
1. Kryetari dhe nënkryetari i Bashkisë, anëtarët e këshillit bashkiak, si dhe drejtuesit e nivelit të lartë drejtues.

- a) Nuk mund të lidhin kontrata me institucionin ku bëjnë pjesë, kryetari dhe nënkryetari i bashkisë, anëtarët e këshillit bashkiak, si dhe drejtuesit e nivelit të lartë drejtues të institucionit.
- b) Për anëtarët e zgjedhur të bashkisë apo edhe të emëruar (kryetari i bashkisë, nënkryetari, dhe anëtarët e këshillit bashkiak) zbatohen edhe dispozitat e parashikuara në nenet 47, 52, 59 pika 4, e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Neni 22

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar i institucionit të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në institucion, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

- a) "Dhurata", sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 874, datë 29.9.2021;
- b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve fafëfisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.

2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normale të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.

4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr. 714, datë 22.10.2004;

5. Në asnjë rast zyrtari i institucionit nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.

6. Përfshihen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 23

Prania dhe kufizimi i interesave private të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e bashkisë, për kufizimet e interesave private të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 19 e 20 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:

- a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
- b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.

2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e bashkisë, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Kufizimet në lidhje me zotërimin të aksioneve, për zyrtarin e bashkisë dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtëpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar

Neni 24

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët e bashkisë bëhen sipas kreut IV të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

Neni 25

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e bashkisë, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

- a) zyrtari i institucionit, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues, dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
- b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i institucionit, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të institucionit është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) kur zyrtari i bashkisë, është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
- b) kur vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
- c) kur vendimet e zyrtarit të institucionit, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
- d) kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
- e) kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i institucionit të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga Drejtoria Juridike, e ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

Neni 26

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

- 1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të institucionit, të drejta që të ndër marrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.
- 2. Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtëpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 27

Rastet e skualifikimit

- 1. Asnjë punonjës i organeve të administratës nuk mund të marrë pjesë në një proces vendimmarrës administrativ apo në një lidhje kontrate ku administrata që ai përfaqëson është palë në rastet kur punonjësi ka ose/ dhe dyshohet të ketë kushtet e mëposhtme:

- a. ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;
- b. bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;
- c. punonjësi apo personat e parashikuar nga paragrafi b) i këtij neni kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë;
- ç. punonjësi ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar apo avokat në çështjen në fjalë;
- d. personat e përmendur në paragrafin b) të këtij neni kanë marrë pjesë si ekspertë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë;
- dh. kundër punonjësit apo ndaj personave të përmendur në paragrafin b) të këtij neni është nisur një proces gjyqësor nga palët e interesuara;
- e. çështja është apelim i një vendimi të marrë prej punonjësit ose nga personat e përmendur në paragrafin b) të këtij neni;
- ë. punonjësi ose personat e përmendur në paragrafin b) të këtij neni janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në një procedim administrativ apo lidhje kontrate ku administrata publike është palë;
- f. punonjësi ose personat e përmendur në paragrafin b) të këtij neni kanë marrë dhurata nga palët e interesuara në procedimin administrativ apo në lidhjen e kontratës përpara ose pas fillimit të procedimit administrativ apo lidhjes së kontratës;
- g. punonjësi ose personat e përmendur në paragrafin b) të këtij neni kanë miqësi ose armiqësi me palët e interesuara në procedimin administrativ apo lidhjen e kontratës.”

Neni 28

Njoftimi i rregullores punonjësve dhe trajnimet për rregulloren

1. Rregullorja i bëhet e njohur çdo punonjësi të institucionit nëpërmjet dërgimit në postën elektronike zyrtare, nëse ka, ose dhënies së një kopje të saj, secilit punonjës të punësuar në kohën e miratimit të saj apo në momentin që punësohet në institucion.
2. Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria Juridike dhe Autoriteti Përgjegjës për paranadalimin e konfliktit të intersave janë përgjegjës për njohjen dhe shpërndarjen e kësaj rregulloreje për të gjithë nëpunësit e Bashkisë Vau Dejës.

Neni 29

Sanksionet

Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, përbëjnë sipas rastit shkelje disiplinore, kundërvajtje administrative apo vepër penale, dhe ndëshkohen sipas parashikimeve ligjore në fuqi

Në rast se zyrtari dhe/ose eprori nuk marrin masat e duhura për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit rast për rast të interesit, ligji PKI parashikon dënime administrative si dhe masa disiplinore që jepen në nenet 44 dhe 45 të tij. Megjithëse Kodi Penal nuk përdor termin “konflikt i interesit”, shkeljet e ligjit PKI, sipas llojit, rrethanave e pasojave, kur për shkak të interesave private zyrtari kryen në mënyrë të padrejtë detyrën, mund të përbëjnë një apo disa nga veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal, të tilla si shpërdorimi i detyrës, korrupsioni pasiv, shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë, falsifikimi i dokumenteve, etj.

Në çdo rast, përgjegjësia penale aktivizohet pavarësisht përgjegjësisë administrative dhe/ose disiplinore dhe anasjelltas.

Neni 30
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, pas firmosjes nga Kryetari i Bashkisë

MIRATOI
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI

Kristian Shkrel

